

BURSA SHQIPTARE ENERGISË ELEKTRIKE – ALPEX SH.A

Nr. 418 Prot.

Tiranë, më 20.11.2023

Lënda: Mbi caktimin e rolit të Agjentit të Transferimit (shipping agent) për bashkimin e tregjeve të energjisë elektrike Shqipërisë – Kosovë.

ZYRËS SË RREGULLATORIT PËR ENERGJI

Rruga: Bekim Fehmiu (Ish Ndërtesa e Fazitës), kati:2, Prishtinë 10000, Kosovë

I nderuar Z. Fejzullahu,

Sikurse jeni në dijeni OST SHA, KOSTT SHA dhe ALPEX SHA janë duke bashkëpunuar në lidhje me realizimin e bashkimit të tregjeve të energjisë elektrike, një ditë para, Shqipëri-Kosovë, në kuadër të përmbushjes të përcaktimeve të marrëveshjes kornizë të datës 21.10.2021 “Mbi bashkimin e tregjeve të energjisë elektrike të Shqipërisë dhe Kosovës”, nënshkruar ndërmjet ERE, ZRrE, OST dhe KOSTT.

Në “Rregullore e kërkesave dhe procedurave për përcaktimin e operatorit të emëruar të tregut të energjisë elektrike (NEMO) si dhe rolet e përgjegjësitë e NEMO dhe Operatorëve të Sistemit të Transmetimit të Energjisë në Tregun e Bashkuar” të miratuar me Vendimin e Bordit të ZRrE-së nr. ZRrE/Nr.04/2020, datë Shtator 2020, është parashikuar, ndër të tjera, edhe roli i Agjentit të Transferimit (shipping agent) dhe konkretisht në nenin 2, “Përkufizime” thuhet se:

“Agjent transferimi” Është person fizik ose juridik që ka për detyrë transferimin e neto pozicioneve në mes Palëve të ndryshme.

Agjenti i transferimit (Shipping Agent) mund të veprojë si kundërpalë ndërmjet kundërpalëve të ndryshme qendrore për shkëmbimin e energjisë elektrike, nëse palët e interesuara lidhin një marrëveshje specifike për këtë qëllim.

Më tej, në rregulloren e miratuar me Vendimin e Bordit të ZRrE-së nr. ZRrE/Nr.04/2020, në Nenin 5 “Detyrat e NEMO” në lidhje me bashkimin e tregut një ditë para dhe atij ndërditorë, përcaktohet se:

NEMO do të jetë veçanërisht përgjegjës për detyrat e mëposhtme:

2.10 Të kryejë rolin e agjentit të transferimit, nëse vendoset nga ZRrE.

dhe në Nenin 6 “Detyrat e OST në lidhje tregun e bashkuar një ditë para dhe atij ndërditorë” përcaktohet se:

Detyrat që KOSTT do të kryej janë si në vijim:

2.11 Të kryejë rolin e agjentit të transferimit, nëse është vendosur nga Rregullatori.

Pra roli i “agjentit të transferimit” në një bashkim tregu vendoset nga ZRrE.

Në rekomandimin e dhënë nga Bordi i Rregullatorëve të Komunitetit të Energjisë (ECRB) në mbledhjen e datës 24.04.2019, e cila është marrë në konsideratë nga ZRrE në hartimin e “Rregullores e kërkesave dhe procedurave për përcaktimin e operatorit të emëruar të tregut të energjisë elektrike (NEMO) si dhe rolet e përgjegjësitë e NEMO dhe Operatorëve të Sistemit të Transmetimit të Energjisë në Tregun e Bashkuar”, Bordi i Rregullatorëve të Komunitetit të Energjisë është shprehur se:

Zakonisht agjentë Transferimi janë NEMO, por është gjithashtu e mundur që OST-të ta kryejnë këtë aktivitet në përputhje me Nenin 8 (l) të Rregullores CACM. Për më tepër, në përputhje me nenin 68 (6.) të Rregullores CACM, një agjent Transferimi mund të veprojë si kundër palë ndërmjet palëve të ndryshme qendrore për shkëmbimin e energjisë, nëse palët e interesuara lidhin një marrëveshje specifike për këtë qëllim.

Për Palët Kontraktuese të Komunitetit të Energjisë rekomandohet gjithashtu t'i referohen një NEMO (d.m.th. operatori i tregut) për t'u përafuar me dispozitat e Rregullores CACM.

Nisur nga ky rekomandim, nga eksperiencia e ndjekur nga vendet evropiane por edhe nga fakti që ALPEX SHA, vepron si një Kundërpalë Qendrore (CCP) për klerimin dhe shlyerjen e shkëmbimit të energjisë që rezulton nga bashkimi i tregut një ditë para, propozojmë që ZRrE të shprehet me vendim, që roli i “Agjentit të transferimit”, për bashkimin e tregjeve të energjisë Shqipëri-Kosovë, të kryhet nga ALPEX SHA.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin, ALPEX SHA, mbetet në dispozicionin tuaj,

Me respekt,

ADMINISTRATORI I ALPEX SHA.

Sokol Dishnica

